



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës: Menaxhimi i Kapitalit të Bankës dhe Sigurimeve

Të dhëna bazike të lëndës

Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i Kapitalit të Bankës dhe Sigurimeve
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	

Përshkrimi i lëndës

Kjo lëndë që ofron njohuri të avancuara për menaxhimin e kapitalit në sektorët bankar dhe të sigurimeve, duke theksuar rëndësinë e praktikave të menaxhimit financiar në kushtet bashkëkohore të afarizmit dhe konkurrencës në ritje. Lënda mbulon aspekte kyçe të strukturës së kapitalit, menaxhimin e riskut financiar dhe të kreditit, dhe ofron një analizë të detajuar të rregullave dhe raporteve që ndikojnë në stabilitetin financiar të institucioneve bankare dhe të sigurimeve.

Qëllimet e lëndës:

- Të pajisë studentët me njohuri të avancuara në fushën e menaxhimit të kapitalit bankar dhe të sigurimeve, duke thelluar kuptimin e tyre mbi strukturën e kapitalit
- Të zhvillojë aftësitë e analizës së riskut dhe menaxhimit financiar – për të ndihmuar studentët të identifikojnë, vlerësojnë dhe menaxhojnë rreziqet që lidhen me operacionet financiare dhe kreditore në bankë dhe

	sigurime, duke përdorur teknika të tilla si stress testing dhe analiza e skenarëve. - Të trajnojnë studentët në formulimin e strategjive efektive të menaxhimit të aktiveve dhe pasiveve për të ruajtur likuiditetin dhe stabilitetin financiar në kushtet e paqëndrueshmërisë së tregut dhe ndryshimeve në normat e interesit. - Të përgatisë studentët për sfidat e ndryshme që sjellin zhvillimet teknologjike dhe dixhitale në sektorët financiarë – përfshirë ndikimin e fintech dhe insurtech në operacionet tradicionale bankare dhe të sigurimeve, duke përfshirë edhe përdorimin e platformave dixhitale për menaxhimin e kapitalit. - Të zhvillojë një perspektivë globale për menaxhimin e kapitalit, ku studentët do të analizojnë ndikimin e faktorëve ndërkombëtarë dhe praktikave më të mira në konkurrencën globale, për të aplikuar konceptet dhe teknikat e mësuara në kontekste të ndryshme kulturore dhe ekonomike. - Të nxisë mendimin kritik dhe të analizuarit strategjik për çështjet financiare – duke i ndihmuar studentët të interpretojnë dhe vlerësojnë ndikimin e politikave financiare, zhvillimeve në tregjet globale dhe ndryshimeve rregullatore në vendimarrjen strategjike të institucioneve financiare. Këto qëllime synojnë që studentët të zhvillojnë një kuptim të thellë dhe të aplikojnë praktikën më të mira për menaxhimin e kapitalit dhe të riskut në bankë dhe sigurime, duke u përgatitur për sfidat e sektorëve financiarë në një ekonomi vendore dhe globale dinamike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1. Kupton dhe analizon parimet kryesore të menaxhimit të kapitalit në sektorët e bankave dhe sigurimeve.

	*NJ2. Identifikon dhe kritikon problemet dhe sfidat kryesore që bankat dhe sigurimet përballen në kushtet bashkëkohore të afarizmit dhe konkurrencës. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1. Zbaton në mënyrë efektive njohuritë e fituara për të menaxhuar kapitalin bankar dhe sigures në rrethana të ndryshme të tregut dhe ekonomi të ndryshme. **A-K2. Përdor analiza financiare dhe teknika të menaxhimit për të identifikuar, vlerësuar dhe minimizuar rreziqet në sektorët bankar dhe të sigurimeve. **A-K3. Zhvillon strategji për përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe konkurrencës së institucioneve bankare dhe sigurimeve duke zbatuar praktikatat bashkëkohore të menaxhimit. Aftësi (A): ***A1. Aftësi për të prezantuar dhe argumentuar në mënyrë bindëse zgjidhje për probleme praktike të menaxhimit në sektorët bankar dhe të sigurimeve. ***A2. Demonstruar aftësi të avancuara për të marrë vendime strategjike në menaxhimin e kapitalit dhe burimeve financiare të institucioneve bankare dhe sigurimeve në tregjet lokale dhe ndërkombëtare. Sqarim: Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) **Aftësi (A)
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30

Punë praktike	1	10	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokviume, seminare	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet ,etj.	1	5	5
Totali			150

Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.

Përshtatja e ECTS me orët totale: $150 \text{ orë} \div 25 = 6 \text{ ECTS kredi}$.

Metodologjia e mësimdhënies:	- Prezantimi i temës mësimore në Power Point - Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime - Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjësuar.
Metodat e vlerësimit:	• Punimi seminarik dhe prezantimi: 0-20% • Kollokviumi i parë: 0-40% • Kollokviumi i dytë: 0-40% • Provimi përfundimtar 0- 80%
Literatura	
Literatura bazë:	• Prof.Dr.Gazmend Luboteni, Menaxhmenti bankar, Prishtinë, 2015. • Kontabiliteti dhe financat për menaxherët në sektorin e sigurimeve, 2021

	Frans de Weert – Bank and Insurance Capital Management, Wiley Finance, 2012
Literatura shtesë:	- Barbara Casu & Claudia Girardone & Phillip Molineux – Hyrje në sektorin bankar, Ars Lamina, 2013. - Timothy W. Koch & S. Scott MacDonald – Bank Management, 7 Edition, - Literature nga raportet e kompanive te sigurimeve https://bks-ks.org/ - Literature nga raportet e bankave: https://www.bankassoc-kos.com/Al/sektori-bankar/ https://bak-kos.org/

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezentimi i syllabusit të lëndës
Java e dytë:	Menaxhimi i kapitalit si një mjet për të krijuar vlerë
Java e tretë:	Modeli i biznesit të Bankës dhe Sigurimeve Bilanci i bankave dhe shoqërive të sigurimit
Java e katërt:	Dallimet midis Bankës dhe Sigurimeve Kapitali Ekonomik
Java e pestë:	Menaxhimi i bilancit Kontabiliteti kundrejt rregullores
Java e gjashtë:	Llojet e kapitalit në dispozicion Instrumentet Kapitale
Java e shtatë:	Kërkesat rregullative për kapital Ndryshime të mundshme në rregullimin e kapitalit
Java e tetë:	Testi i parë vlerësues
Java e nëntë:	Testi i mjaftueshmërisë së rezervës
Java e dhjetë:	Materializimi i përfitimeve të diversifikimit përmes Strukturave të Kapitalit Optimizimi i aktiveve të ponderuara sipas rrezikut
Java e njëmbëdhjetë:	Analiza e bilancit si pjesë përbërëse e vlerësimit Investimi i Kapitalit dhe Segmentimi i Bilancit
Java e dymbëdhjetë:	Përafrimi ndërmjet riskut dhe menaxhimit të kapitalit
Java e trembëdhjetë:	Marrja e vendimeve për financat e korporatave

Java e katërbëdhjetë:	Diversifikimi Strategjik
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.